

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-566/2022	Data: Datum: 01.08.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62 i miratuar me datën 30.11.2010, për ndarjen e mjeteve buxhetore për pagesën e qeras dhe bazuar në kontratat e lidhura me numër 01-Nr.536/2022 të datës 26.07.2022 në mes të komunës si qiramarrës Muzli Muzlijaj-qiradhënës dhe shfrytëzuesit të qirasë Blerina Tafilaj me vendbanim në Ish Burgun e Gurakocit, nxjerr:

V E N D I M

1. **NDAHEN:** mjete buxhetore për pagesën e qeras për qiradhënësin **Muzli Muzlijaj**, në shumë prej **1,200,00€(një mijë e dyqind euro)**.
2. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga 200€ (dyqind euro) në muaj e atë për gjashtë muaj në xhironlogarinë e Muzli Muzlijaj, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime publike 18017-kategoria ekonomike mallra dhe shërbime kodi ekonomik 14110-qiraja për ndërtesa.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Shërbime Publike,
- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-567/2022	Data: Datum: 01.08.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62 i miratuar me datën 30.11.2010, për ndarjen e mjeteve buxhetore për pagesën e qeras dhe bazuar në kontratat e lidhura me numër 01-Nr.534/2022 të datës 26.07.2022 në mes të komunës si qiramarrës Mirlind Mavraj-qiradhënës dhe shfrytëzuesit të qirasë Florentina Mehmetaj, me vendbanim në Ish Burgun e Gurakocit, nxjerr:

V E N D I M

1. **NDAHEN:** mjete buxhetore për pagesën e qeras për qiradhënësin **Mirlind Mavraj**, në shumë prej **1,200,00€(njëmijë e dyqind euro)**.
2. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga 200€ (dyqind euro) në muaj e atë për gjashtë muaj në xhirollogarinë e Mirlind Mavraj, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime publike 18017-kategoria ekonomike mallra dhe shërbime kodi ekonomik 14110-qiraja për ndërtesa.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Shërbime Publike,
- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-568/2022	Data: Datum: 01.08.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62 i miratuar me datën 30.11.2010, për ndarjen e mjeteve buxhetore për pagesën e qeras dhe bazuar në kontratat e lidhura me numër 01-Nr.535/2022 të datës 26.07.2022 në mes të komunës si qiramarrës Ibrahim Çlirim Rracaj-qiradhënës dhe shfrytëzuesit të qirasë Kamber Kikaj, me vendbanim në Ish Burgun e Gurakocit, nxjerr:

V E N D I M

1. **NDAHEN:** mjete buxhetore për pagesën e qeras për qiradhënësin **Ibrahim Çlirim Rracaj**, në shumë prej **1,200,00€(një mijë e dyqind euro)**.
2. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga 200€ (dyqind euro) në muaj e atë për gjashtë muaj në xhirrologarinë e Ibrahim Çlirim Rracaj, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime publike 18017-kategoria ekonomike mallra dhe shërbime kodë ekonomik 14110-qiraja për ndërtesa.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Shërbime Publike,
- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-571/022	Data: Datum: 01.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe bazuar në nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën 01Nr.016-29350 të datës 14.07.2022, të parashtruar nga Daut Elshani nga fsh.Staradran për përkrahje financiare për mirëmbajtjen e Lapidarit të Dëshmoreve në fsh.Staradran dhe i propozoi Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 01Nr.016-29350 e datës 14.07.2022, e parashtruar nga Daut Elshani, për përkrahje financiare për mirëmbajtjen e Lapidarit të Dëshmoreve në fsh.Staradran dhe përkrahet financiarisht në shumë prej **250.00€,(dyqind e pesëdhjete euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit.
- Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Daut Elshanaj në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Daut Elshani, ka parashtruar kërkesën 01Nr.016-29350 të datës 14.07.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për mirëmbajtjen e Lapidarit të Dëshmoreve në fsh.Staradran.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Daut Elshani ka kërkuar mjete financiare në shumë prej **300.00€,(treqind euro)** por në mungesë të mjeteve financiare përkrahet financiarisht në shumë prej **250.00€ (dyqind e pesëdhjete euro)** për shkak të rëndësisë së realizimit e projektit të cekur më lartë.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Daut Elshanit,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Bir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-572/2022	Data: Datum: 01.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe bazuar në Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01Nr.68/2021 të miratuar me datë 29.06.2021, Drejtoria për Shërbime Publike, shqyrtoi kërkesën 08 Nr.120-31751 të datës 26.07.2022 të parashtruar nga Prend Ukaj nga fsh.Kosh, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e nënës Zoja Ukaj dhe i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 08 Nr.120-31751 e datës 26.07.2022, e parashtruar nga Prend Ukaj, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e nënës Zoja Ukaj dhe sipas Rregullores përkrahet me mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime kodi ekonomik 13490-shpenzime të varrimit nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike kodi i programit buxhetor 18017.
- 2.** Mjetet e përcaktuara, në pikën 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Prend Ukaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
- 3.** Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.
- 4.** Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Prend Ukaj,
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-573/2022	Data: Datum: 01.08.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-jë, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 29.07.2022, nga Drejtoria Komunale e Arsimit për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit: për projektin “Sigurimi i nxënësve në praktikën profesionale SHMLP “Mithat Frasheri” në Gurrakoc, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-7234-2-3-6 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-038-236, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit: Sigurimi i nxënësve në praktikën profesionale SHMLP “Mithat Frasheri” në Gurrakoc, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-7234-2-3-6 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-038-236, dhe në komision caktohen:

- 1.1. Januz Ahmetaj,** Zëvendës Drejtor në SHMLP “Mithat Frasheri” në Gurrakoc, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Naim Sadriu,** Zyrtar për Standarde, Monitërim dhe Vlerësim, anëtar dhe
- 1.3. Sami Metaj,** Zyrtar Ligjor, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit: “Sigurimi i nxënësve në praktikën profesionale SHMLP “Mithat Frasheri” në Gurrakoc”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria Komunale për Arsim.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë Komunale për Arsimi
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-576/022	Data: Datum: 02.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nën 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nën 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-18662 të datës 13.05.2022 të parashtruar nga Fakete Axhijaj, nga fsh. Fakete Axhijaj, nga fsh. Veriq Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-18662, e datës 13.05.2022 e parashtruar nga Fakete Axhijaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Fakete Axhijaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Fakete Axhijaj, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-18662, të datës 13.05.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Fakete Axhijaj është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapinë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)**.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Fakete Axhijaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Hijr FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-577/2022	Data: Datum: 03.08.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62 i miratuar me datën 30.11.2010, dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, dahan mjete buxhetore Subvencione dhe Transfere nga pesë Programe -Nenprograme buxhetore, nxjerr:

V E N D I M

- 1. NDAHEN:** mjete buxhetore Subvencione dhe Transfere nga pesë Programe-Nenprograme buxhetore si me poshtë:

- 1.1. Nënprogrami buxhetor Administrata e shëndetësisë (73026), ndanë shumën prej 8,750.00€, përkrahje financiare për shërim sipas vendimeve të cilat janë në lëndë;
- 1.2. Nënprogrami buxhetor-Zyra e Kryetarit (16017), ndanë shumën prej 1,250.00€, përkrahje financiare për shërim sipas vendimeve të cilat janë në lëndë;
- 1.3. Nënprogrami buxhetor-Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (19585), ndanë shumën prej 450.00€, përkrahje financiare për shërim sipas vendimeve të cilat janë në lëndë;
- 1.4. Nënprogrami buxhetor-Shërbime Publike dhe Infrastrukturë (18017), ndanë shumën prej 3,450.80€, për kompensim të demit të shkaktuar nga zjarri sipas vendimit i cili është në lëndë;
- 1.5. Nënprogrami buxhetor-Administratës së Arsimit (92085), ndanë shumën prej 450.00€, për ndihmën e familjeve për transport të nxënësve, sipas vendimeve të cilat janë në lëndë.

- 2.** Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi, Zyra e Kryetarit, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe ZKF-ja.

- 4.** Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,
- Drejtorisë për Shërbime Publike,
- Drejtorisë Komunale të Arsimit,
- ZKF-së
- Arkivi i zyrës së Kryetarit dhe

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ


Kryetari Komunës
z.Illir FERATI

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-579/022	Data: Datum: 04.08.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 34 paragrafin 12 të Ligjit Nr.114, për Zyrtarët Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës Nr.8/2019) dhe bazuar në nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020, për Pranimin në Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shqyrtoj kërkesën me 02Nr.153/22 e datës 02.08.2022, e parashtruar nga Menaxheri i Personelit për themelimin e Komisionit të pranimit për zhvillim të procedurave të rekrutimit, nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 02Nr.153/22 e datës 02.08.2022 e parashtruar nga Menaxheri i Personelit për themelimin e Komisionit të pranimit për zhvillim të procedurave të rekrutimit-pranim në kategori për pozitë: **Zyrtar Ligjor**, sipas konkursit të publikuar me datën 28.06.2022 dhe Komisioni i pranimit themelohet me këtë përberje si me poshtë:
 1. **Fatmir Bytyçi** – Menaxher i Personelit;
 2. **Faton Bujupi** – Udh. i Zyres së Gjendjës Civile;
 3. **Arsim Berisha**, Zyrtar për Kadastër;
 4. **Enisa Corovic** – Zyrtare për Koordinimin e të drejtave dhe Integrim të Komuniteteve;
 5. **Haxhi Metaj** – Expert i Jashtëm
2. Punët e Komisionit të lartëcekur janë të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe me Rregulloreën (QRK) Nr.16/2020 për pranim dhe karrierë në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
3. Të gjitha punët tekniko-administrative për nëvoja të komisionit do t'i kryejë Zyra e Personelit.
4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni.
5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dergohet:

- Komisionit të pranimit;
- Njësisë për Burime Njerzore dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.580/2022	Data: Datum: 06.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 22 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2. të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010) dhe nenit 19 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj lajmërimin 02 Nr.150/2022 të datës 01.08.2022 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për pagesën e një page mujore me përfundimin e shërbimit-pensionimin e Musa Kaliqani, nëpunës civil me titull të vendit të punës: Udhëheqës i Sektorit për Regjistrimin e Biznesit, nxjerr:

V E N D I M

- KOMPENZOHE:** Musa Kaliqani, nëpunës civil me titull të vendit të punës: Udhëheqës i Sektorit për Regjistrimin e Biznesit, në Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim, në lartësi prej një page mujore të cilën e ka realizuar deri në pensionim.
- Nëpunësit civil të lartpërmendur i përfundon shërbimi me **13.08.2022**.
- Pagesa e mjeteve të cekura në pikën 1. e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim.
- Zyrtari Financiar-përgjegjës për Paga, Mëditje dhe Kompensime obligohet që Musa Kaliqanit t'ia bëjë pagesën e një page mujore të realizuar, sipas procedurave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, Zyrtari Financiar-përgjegjës për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe Menaxheri i Personelit.
- Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve të administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Musa Kaliqani,
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim,
- Zyrtari Financiar-përgjegjës për Paga, Mëditje dhe Kompensime,
- Menaxheri i Personelit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. 581/2022	Data: 06.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 67 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenin 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi Vendimin për përfundimin e shërbimit-pensionimi 05.Nr.550/2022 të datës 01.08.2022, të parashtruar nga Drejtoria Komunale për Arsim për kompensimin në lartësi prej 3(tri) pagave mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Bajram Visoqi, me titull të postit: Mësimdhënës i Edukatës Fizike në SHMLP "Mithat Frasheri" në Gurakoc, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 05.Nr.550/2022 të datës 01.08.2022 e parashtruar nga Drejtoria Komunale për Arsim për kompensimin në lartësi prej 3 (tri) pagave mujore që i ka marr për tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Bajram Visoqi, me titull të postit: Mësimdhënës i Edukatës Fizike në SHMLP "Mithat Frasheri" në Gurakoc.

2. Mësimdhënësit të lartpërmendur i përfundon shërbimi me **15.08.2022**.

3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.

4. Zyrtari Financiar-përgjegjës për Paga, Mëditje dhe Kompensime në Drejtorinë Komunale për Arsim, obligohet që Bajram Visoqit, t'ia bëjë pagesën e 3(tri) pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.

5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale për Arsim dhe Zyrtari Financiar-përgjegjës për Paga, Mëditje dhe Kompensime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Inspektoratit të Punës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Bajram Visoqit,
- Drejtorisë Komunale për Arsim;
- Zyrtarit Financiar- përgjegjës për Paga, Mëditje dhe kompensime dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI


 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-582/2022	Data: Datum: 06.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 22, paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr.03/L-147 dhe nenin 22, paragrafi 2 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj kërkesën Nr.01-120-32550, të datës 29.07.2022, të parashtruar nga Emina Coković nga fsh. Kovragë, Komuna e Istogut, nëpunës civil, për kompensimin për vdekjen anëtarit të ngushtë të familjes prindit-nënës (**Dževahira Coković**), nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-120-32550 e datës 29.07.2022, e parashtruar nga **Emina Coković**, Zyrtare Financiare në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, për kompensimin për vdekjen anëtarit të ngushtë të familjes prindit-nënës (**Dževahira Coković**) dhe i ndahen mjetet financiare në shumën prej **389.20 €** (treqind e tetëdhjete e nëntë euro e njëzet cent) ndihmë për nëpunësin civil, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, kategoria ekonomike paga dhe mëditje kodi ekonomik 11155-shtesat dhe kompensimet tjera
2. Mjetet e cekura në piken 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Emina Coković, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Emina Coković,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-583/022	Data: Datum: 06.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58, pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe bazuar në Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01Nr.68/2021 të miratuar me datë 29.06.2021, Drejtoria për Shërbime Publike, shqyrtoi kërkesën 08 Nr.120-32556 të datës 29.07.2022, të parashtruar nga Emina Coković nga fsh. Kovragë, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e nënës (**Dževahira Coković**) dhe i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 08 Nr.120-32556 e datës 29.07.2022 e parashtruar nga **Emina Coković**, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e nënës (**Dževahira Coković**) dhe sipas Rregullore përkrahet me mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime kodi ekonomik 13490-shpenzime të varrimit nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike kodi i programit buxhetor 18017.
- 2.** Mjetet e përcaktuara, në pikën 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Emina Coković, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
- 3.** Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.
- 4.** Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Emina Coković,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-584/2022	Data: Datum: 08.08.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e datës 08.08.2022 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis për themelimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për ndryshimin e draft Hartës zonale 2022-2030 dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për ndryshimin e draft Hartës Zonale 2022-2030 dhe në Komision caktohen:

1. **Dukagjin Hoxhaj, Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis,**
Kryesues i Komisionit,
2. **Genc Ademaj,** Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtar,
3. **Elfete Blakaj,** Udhëheqëse e Sektorit për Mjedis, anëtare,
4. **Rexhep Blakaj,** Udhëheqës i Sektorit për Urbanizëm, anëtar dhe
5. **Masar Kabashi,** përfaqësues i OJQ "Klubi Alpin Podguri".

2. Komisioni i cekura më lartë ka për obligim që ti shqyrtoj të gjitha kërkesat e parashtruara për ndryshimin e draft Hartës zonale 2022-2030; do t'ju kthej përgjigje të gjitha palëve; si dhe do t'i kryej punët dhe përgjegjësitë tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Komisioni obligohet t'ia filloj punës menjëherë me datën 08.08.2022 si dhe merr përgjegjësi për shqyrtimin e kërkesave për ndryshimin e draft Hartës zonale 2022-2030.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Komisioni.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 586/2022	Data: Datum: 08.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-31835, të datës 26.07.2022, të parashtruar nga z.Ermal Rexhaj, nga fsh.Cerrcë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e prindit (Qerim Rexhaj) në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-31835, të datës 26.07.2022, e parashtruar nga z.Ermal Rexhaj, për përkrahje me karburant për dërgimin e prindit të tij në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore(Radioterapisë) dhe i lejohen 250 litra karburant.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë z.Ermal Rexhaj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Ermal Rexhaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-31835, të datës 26.07.2022, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i prindit Qerim Rexhaj.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se z.Qerim Rexhaj, është i sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e tij për marrjen e terapisë në QKUK në Prishtinë.

I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij për në Prishtinë për marrjen e terapisë.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: z.Ermal Rexhaj, Drejtoria për Shëndetësi, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udh. sektorit ligjor

Zekije Sutaj




Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-586/2022	Data: Datum: 08.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 08.08.2022, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Asgjësimi i mbetjeve medicinale”, nxjerr:

V E N D I M

- 1. CAKTOHET:** Menaxher i kontratës **z.Tahir Tafilaj**, QKMF dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës **CAKTOHET: Dr.Tahir Kaligani**, Udhëheqës i Mjekësisë Familjare, për projektin: “Asgjësimi i mbetjeve medicinale”, me numër të jashtëm prokurimi 633-21-8090-2-2-1 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-021-059-221, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatorëve ekonomik “**MetBat**” SH.P.K, me seli në Malet e Krivoves.
- Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
- Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e marr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë.
- Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- z.Tahir Tafilaj, Menaxher i kontratës,
- Dr.Tahir Kaligani, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës-ZKA
z.Illir FERATI

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-589/2022	Data: Datum: 11.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 09.08.2022, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Mirëmbajtja e institucioneve komunale (komunë, arsim dhe shëndetësi)”, nxjerr:

V E N D I M

- CAKTOHET:** Menaxher i kontratës për shëndetësi **z.Bekim Dreshaj**, QKMF dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës **CAKTOHET: Dr.Tahir Kaliqani**, Udhëheqës i Mjekësisë Familjare, Menaxher i kontratës për arsim **CAKTOHET: z.Brahim Bytyçi**, Drejtor i Gjimnazit “Haxhi Zeka” dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës **CAKTOHET: z.Naim Behluli**, Drejtor i Drejtorisë Komunale për Arsim, Menaxher i kontratës për komunë caktohet: **Hasan Shala**, Mirëmbajtës i objektit të komunës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës **CAKTOHET: z.Arben Kabashi**, Drejtor i Drejtorisë për Administratë Komunale, për projektin: “Mirëmbajtja e institucioneve komunale (komunë, arsim dhe shëndetësi)”, me numër të jashtëm prokurimi 633-22-4569-1-2-1 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-022-017-121, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar Grupi i operatorëve ekonomik “AIX G.C.W.” SH.P.K. & “INTERING CONSTRUCTION” SH.P.K.me seli në Fushë Kosovë.
- Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
- Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e marr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë.
- Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- z.Bekim Dreshaj, Menaxher i kontratës,
- Dr.Tahir Kaliqani, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës,
- z.Brahim Bytyçi, Menaxher i kontratës,
- z.Naim Behluli, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës,
- z.Hasan Shala, Menaxher i kontratës,
- z.Arben Kabashi, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës-ZKA
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-590/2022	Data: Datum: 11.08.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 08.08.2022, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit: Lot1 “Ndërtimi i kalldas në SHMLP “Mithat Frasheri” në Gurakoc (furnizim); Lot 2 “Ndërtimi i kalldas në SHFMU “Zymer Zeka” në Kaliqan (furnizim), me numër të jashtëm prokurimi 633-022-7152-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-037-121, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit: Lot1 “Ndërtimi i kalldas në SHMLP “Mithat Frasheri” në Gurakoc (furnizim); Lot 2 “Ndërtimi i kalldas në SHFMU “Zymer Zeka” në Kaliqan (furnizim), me numër të jashtëm prokurimi 633-022-7152-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-037-121 dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Januz Ahmetaj**, Zëvendës Drejtor në SHMLP “Mithat Frasheri” në Gurakoc, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Muhamet Ukaj**, Drejtor në SHFMU “Zymer Zeka” në Kaliqan, anëtar dhe
- 1.3. **Zizë Bujupaj**, Udhëheqëse e Sektorit për Arsim, anëtare.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit: Lot1 “Ndërtimi i kalldas në SHMLP “Mithat Frasheri” në Gurakoc (furnizim); Lot2 “Ndërtimi i kalldas në SHFMU “Zymer Zeka” në Kaliqan (furnizim), me qellim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t'iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtorisë për Shëndetësi.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë Komunale për Arsim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-591/2022	Data: Datum: 11.08.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/-010 të miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën e prokurimit të datës 11.08.2022, për themelimin e komisionit për verifikimin e punëve për projektin: “Ndërtimi i teshtoreve në stadiumin e futbollit “Demush Mavraj” në Istog–faza e dytë, me numër të jashtëm prokurimi 633-21-2922-5-2-1/C505 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-21-022-5-2-1/C505, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për verifikimin e punëve për projektin: “Ndërtimi i teshtoreve në stadiumin e futbollit “Demush Mavraj” në Istog–faza e dytë, të cilin e ka realizuar operatori ekonomik “AAG PROJEKT” SH.P.K, me seli në Prishtinë dhe në komision caktohen:

- 1.1. z.Rrustem Gashi,** Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. z.Blerim Bujupi,** Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar;
- 1.3. znj.Qefsere Ibrahimaj,** Zyrtare e Lartë për Trashëgimi Kulturore dhe Arkiv të Qytetit, anëtare.

I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij për në Prishtinë për marrjen e terapisë. Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: z.Zeqir Blakaj, Drejtoria për Shëndetësi, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udh. sektorit ligjor
Zekije Sutaj

[Signature]



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-609/022	Data: Datum: 19.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në dispozitat e Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, shqyrtoj kërkesën 12 Nr.73/2022 të datës 19.08.2022 të parashtruar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për shpalljen e thirrjes së dytë publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve dhe i propozoi Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 12 Nr.73/2022 e datës 19.08.2022 e parashtruar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për shpalljen e thirrjes së dytë publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
2. Për zbatimin Thirrjes publike si në pikën 1 të këtij vendimi do të zbatohen dispozitat e Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
3. Mbështetja financiare nga thirrja publike do të bëhet nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe përgjegjës për zbatimin e tij është: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
5. Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01.610/022	Data: Datum: 19.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 2 të Rregullores MF Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.178/2022 të datës 17.08.2022 të parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, për shpalljen e thirrjes publike për OJQ, për organizimin e ditës tradicionale të vjelës së mollës- “Dita e Mollës” dhe i propozoi Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 09 Nr.178/2022 e datës 17.08.2022 e parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, për shpalljen e thirrjes publike për OJQ, për organizimin e ditës tradicionale të vjelës së mollës-“Dita e Mollës” dhe ndahen mjete buxhetore në shumë prej **3,000.00€ (tremijë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
2. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, obligohet që në kohë me të shkurtër të publikoj thirrjen publike për organizimin e ditës së vjeljes së mollës- “Dita e Mollës” si dhe ti kryej të gjitha punët deri në përfundim të kij aktiviteti.
4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe përgjegjës për zbatimin e tij është: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
5. Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-611/2022	Data: Datum: 19.08.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) në nenin 8 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ 10/2014 Punët dhe Kriteret për Vendosjen e Rezidentëve në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare në Shtëpinë me Bazë në Komunitet, shqyrtoj kërkesën 06 Nr.72/2022 të datës 19.08.2022 të parashtruar nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale për ndërrimin e Kryesuesit të Komisionit në Vendimin 01Nr.16 të datës 19.01.2022 për shqyrtimin e kërkesave për lejimin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, nxjerr:

V E N D I M

1. Ndërrohet anëtari i komisionit për shqyrtimin e kërkesave për lejimin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, **Valmir Gjoci** zëvendësohet me **Arbnora Arifaj**:

1.1. Arbnora Arifaj, Dr. i Mjekësisë së Përgjithshme, Kryesues i Komisionit;

1.2. Shfaqet Shatri, Infermier, anëtar dhe

1.3. Fisnik Shoshaj, Zyrtar Ligjor në DSHMS, anëtar.

2. Komisioni i lartcekur cekur do të bëjë shqyrtimin e të gjitha kërkesave për lejimin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc.
3. Personat të cilët plotësojnë kriteret sipas Ligjeve dhe akteve nenëligjore në fuqi, mund t'ju lejohet vendosja në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit).
4. Komisioni obligohet të njoftoj: Kryetarin e Komunës; Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale; Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit); Qendrën për Punë Sociale dhe parashtruesin e kërkesës për strehimin apo mos strehimin e personave të moshuar.
5. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevojat të komisionit do t'i kryejë, Drejtoria për Mirëqenie Sociale.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Komisioni.
7. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Valmir Gjocit,
- Arbnora Arifaj,
- Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-612/022	Data: Datum: 19.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/-010 të miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.58/2022 të datës 08.08.2022 të parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, për lejimin e furnizimit me dru zjarri për qytetaret e Komunës së Istogut, nxjerr:

V E N D I M

- 1. LEJOHET:** që qytetaret e komunës së Istogut të furnizohen me dru zjarri.
- Agjensioni Pyjor i Kosovës bazuar në planin vjetor të menaxhimit të Pyjeve ka paraparë shitje të lirë të masës drusore me qellim që qytetaret e Komunës së Istogut të furnizohen me dru zjarri.
- Drejtoria e Agjencionit të Pyjeve në Pejë ka lejuar 504.37 metër kub dru për zjarr dhe sipas çmimorës çmimi për metër kube është 16€.
- Qytetaret e interesuar për furnizimin me dru zjarri obligohen të vijnë në komunë për marrjen e fletëpagesës.
- Ky Vendim hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
- Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-613/2022	Data: Datum: 23.08.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 23.08.2022, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit: “Demolimi dhe largimi i objekteve të pa përdorshme”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-8085-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-22-047-521, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit: “Demolimi dhe largimi i objekteve të pa përdorshme”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-8085-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-22-047-521 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Xhavit Blakaj,** Udhëheqës i Sektorit për Inspektion, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Naser Nimanaj,** Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, anëtar dhe
- 1.3. Hysen Mehmetaj,** Inspektor i Tregut, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit: “Demolimi dhe largimi i objekteve të pa përdorshme”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Inspektion.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Inspektion dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-617 /022	Data: Datum: 24.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 12 par 12.3 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.04/L-081, nenin 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2011 për punët dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpinë me bazë në komunitet, Komisioni i Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për shqyrtimin e kërkesave dhe pranimin e rezidentëve në Shtëpinë e Komunitetit në Gurakoc, shqyrtoi kërkesën Nr.154/2022, të datës 23.08.2022, të parashtruar nga Shtëpia për Komunitete në Gurakoc, për lejimin e strehimit të përhershëm institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për Mehmet (Ukë) Nitaj, nga fshati Drenoc, Komuna e Pejës dhe i propozon Kryetarit të Komunës të nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.154/2022, e datës 23.08.2022, e parashtruar nga Shtëpia për Komunitete në Gurakoc, për lejimin e strehimit të përhershëm institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për Mehmet (Ukë) Nitaj, me nacionalitet shqiptar, me shtetësi kosovar i lindur me 13.10.1946, në fshati Drenoc, Komuna e Pejës.
2. Komisioni për rastin në fjalë ka vendos ti lejoj strehimin e përhershëm pasi i njeiti në periudhen testuese prej 6 Mujave ka pasur sjellje te mira dhe konformë rregullave te shtëpisë për Komunitete..
3. Shtëpia e Komunitetit në Gurakoc është përgjegjëse për përkujdesjen ndaj Mehmet (Ukë) Nitaj, gjatë qëndrimit në këtë institucion.
4. Obligohet Organi i Kujdestarisë pranë QPS-së që të përcjell dhe të mbikqyrë gjëndjen e klientit në shtëpinë e komunitetit në Gurakoc.
5. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Drejtoria për Mirëqenie Sociale shqyrtoj, kërkesën Nr.154/2022, të datës 23.08.2022 e parashtruar nga Shtëpia për Komunitete në Gurakoc, për strehimin e të moshuarëve, kërkes kjo per vazhdimin e strehimit të përhershëm të Mehmet (Ukë) Nitaj i cili jeton tash e 6 Muaj në Shtëpinë për Komunitete në Gurakoc, periudhë kjo testuese e cila tregon për se afermi sjelljet e tij konformë rregullave të shtëpisë si dhe ambientimin e tij me banim kolektiv. Gjendja shëndetësore e tij për momentin është e mirë pa probleme mendore, statusi familjar ka qenë i martuar por që i ka vdekur bashkëshortja, ka pas nje vella i cili poashtu ka vdekur me emrin Bardh para disa viteve, ka nje pension kontributdhënes pre 180.00€, banesa në te cilen ka banuar me bashkëshorte e ka shitë, nuk ka fëmijë biologjik as të adoptuar, ka tre vellezer dhe një moter, por që nuk ka kontakt me ta.

Komisioni për rastin në fjalë ka vendos ti lejoj strehimin e përhershëm të tij në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Mehmet (Ukë) Nitaj,
- Merita Muzliqaj-Bytyçi-Drejtoresh për Mirëqenie Sociale,
- Ilaki Ibrahimaj, Drejtor i QPS-së në Istog,
- Menaxheri i shtëpisë së komunitetit në Gurakoc dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ





 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-618/2022	Data: Datum: 24.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 18.08.2022, për caktimin e Menaxherit të kontratës kornizë dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal”, nxjerr:

V E N D I M

- 1. CAKTOHET:** Menaxher i kontratës kornizë **z.Naser Nimanaj**, Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës **CAKTOHET: z.Abedin Kabashi**, Drejtorë i Drejtorisë për Shërbime Publike për projektin: “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal”, me numër të jashtëm prokurimi 633-21-1831-2-2-1 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-021-013-221, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori ekonomik **“LINDI MARKINGS” SH.P.K** me seli në Vitomeric, Komuna e Pejës.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
3. Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e marr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë.
5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- z.Naser Nimanaj, Menaxher i kontratës,
- z.Abedin Kabashi, Drejtorë i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-620/2022	Data: Datum: 24.08.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13-dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/-010 të miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi 09 Nr.183 të datës 19.08.2022, për themelimin e komisionit për verifikimin e punëve për projektin: “Mirëmbajtja e rrugëve malore Lot1 Radusha dhe Lot2 Lugu i Butë”, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për verifikimin e punëve për projektin: “Mirëmbajtja e rrugëve malore Lot1 Radusha dhe Lot2 Lugu i Butë” me numër të jashtëm prokurimi 633-22-5771-5-2-1/C561 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-22-025-5-2-1/C561, të cilin e ka realizuar operatori ekonomik “Te Aleni” SH.P.K, me seli në Vrellë dhe në komision caktohen:

1.1. z.Bajram Sejdiqaj, Teknik i Pylltarisë për Mbrojtje dhe Monitorim, Kryesues i Komisionit;

1.2. z.Abedin Dreshaj, Teknik i Gjuetisë, Pylltarisë dhe Peshkimit, anëtar;

1.3. z.Bajram Sadriqaj, Teknik i Gjuetisë, Pylltarisë dhe Peshkimit, anëtar.

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartëcekur; do të hartojë raportin për pranimin teknik të projektit si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e komisionit të tillë.

3. Përgjegjësin për pranimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë, pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Prokurimi dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

5. Vendimi është për përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

-Komisionit,

-Prokurimit,

-Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe

-Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-621/2022	Data: Datum: 24.08.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/-010 të miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 12 Nr.71/2022 të datës 17.08.2022 të parashtruar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për ndërrimin e Menaxherit të kontratës sipas vendimit 01 Nr.398 të datës 13.06.2022 për projektin “Ndërtimi i Qendrës Rinore në fsh. Uçë, nxjerr:

V E N D I M

1. **NDERROHET:** Menaxheri i kontratës i caktuar me vendimit 01 Nr.398 të datës 13.06.2022 për projektin “Ndërtimi i Qendrës Rinore në fsh. Uçë.
2. Burbuqe Pepaj ing. e Ndërtimtarisë e caktuar menaxhere e kontratës për projektin e lartcekur nuk mund të menaxhoj realizimin e kontratës për shkak të volumit të punëve dhe caktohet Menaxher i kontratës”PMN” SH.P.K.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: ”PMN” SH.P.K dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport .
3. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- ”PMN” SH.P.K.
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
 z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 622/022	Data: Datum: 24.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 01 Nr.553-11690 të datës 28.03.2022 të parashtruar nga Skender Nurçaj, nga fsh.Kashicë, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e bashkëshortes, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 01 Nr.553-11690, e datës 28.03.2022 e parashtruar nga Skender Nurçaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e bashkëshortes dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **500.00€ (pesëqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i zyrës së kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Skender Nurçaj në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Skender Nurçaj, ka parashtruar kërkesën 01 Nr.553-11690, të datës 28.03.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se znj.Fatmira Nurçaj, është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **500.00€ (pesëqind euro)**.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësisë buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Skender Nurçaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ





 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-623/2022	Data: Datum: 25.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 25.08.2022, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Instalimi i kamerave në institucionet shkollore”, nxjerr:

V E N D I M

- 1. CAKTOHET:** Menaxher i kontratës **z.Skender Hasngjekaj**, Udhëheqës i Sektorit për Emergjencë dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës **CAKTOHET: z.Naim Behlulaj**, Drejtorë i Drejtorisë Komunale për Arsime për projektin: “Instalimi i kamerave në institucionet shkollore”, me numër të jashtëm prokurimi 633-21-7304-1-2-1 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-22-042-121, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori ekonomik **“ELEKTRA” L.L.C** me seli Komuna e Hani i Elezit.
- Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
- Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e marr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë.
- Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- z.Skender Hasngjekaj, Menaxher i kontratës,
- z.Naim Behlulaj, Drejtorë i Drejtorisë Komunale për Arsime dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-624/2022	Data: Datum: 26.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) Drejtoria Komunale për Arsim, shqyrtoj kërkesë 05-553-38293 të datës 24.08.2022 të parashtruar nga z.Nuredin Imeraj përfaqësues i Klubit Letrar “Podguri” dhe i propozon kryetarit me shkresë 05 Nr.580/2022 të datës 26.08.2022 për përkrahje me karburant, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 05-553-38293 e datës 24.08.2022 e parashtruar nga **z.Nuredin Imeraj**, përfaqësues i Klubit Letrar “Podguri” dhe përkrahët me 60 litra karburant-naftë, për pjesëmarrje në takimin e parapërgatitur për projektin letrar “Ibrahim Rugova” i cili takim do të mbahet në Kryeqytetin e Shqipërisë-Tiranë.

2. Obligohet Zyrtari i transportit që **z.Nuredin Imeraj**, të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejnë për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Zyrtari i Transportit.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- z.Nuredin Imeraj,
- Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-627/022	Data: Datum: 26.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe bazuar në Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01Nr.68/2021 të miratuar me datë 29.06.2021, Drejtoria për shërbime Publike, shqyrtoi kërkesën 08 Nr.120-34263 të datës 05.08.2022, të parashtruar nga Teuta Çuni nga fsh. Serbobran, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babit (**Remzi Çuni**) dhe i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 08 Nr.120-34263 e datës 05.08.2022 e parashtruar nga **Teuta Çuni**, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babit (**Remzi Çuni**) dhe sipas Rregullores përkrahet me mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime kodi ekonomik 13490-shpenzime të varrimit nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike kodi i programit buxhetor 18017.

2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Teuta Çuni, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Teuta Çuni,
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-628/022	Data: Datum: 26.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe bazuar në Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01Nr.68/2021 të miratuar me datë 29.06.2021, Drejtoria për shërbime Publike, shqyrtoi kërkesën 08 Nr.120-34238 të datës 05.08.2022, të parashtruar nga Armend Gusturanaj nga fsh. Istogu, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babait (Qazim Gusturanaj) dhe i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 08 Nr.120-34238 e datës 05.08.2022 e parashtruar nga **Armend Gusturanaj**, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babait (**Qazim Gusturanaj**) dhe sipas Rregullores përkrahet me mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime kodi ekonomik 13490-shpenzime të varrimit nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike kodi i programit buxhetor 18017.

2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Armend Gusturanaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Armend Gusturanaj,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-646/2022	Data: Datum: 26.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 11.08.2022, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Mirëmbajta e Ndriçimit Publik”; nxjerr:

V E N D I M

1. **CAKTOHET:** Menaxher i kontratës z.**Rasim Mahmutović**, Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim dhe **CAKTOHET:** Mbikëqyrës i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës z.**Abedin Kabashi**, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike për projektin: “Mirëmbajta e Ndriçimit Publik” me numër të jashtëm prokurimi 633-022-7153-2-2-1 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-022-035-221, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar “TONI INGJINJERING” B.I. nga Llapushniku.

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualet për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.

3. Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- z-Rasim Mahmutović, Menaxher i kontratës
- z.Xhevat Demaj,-Mbikëqyrës i Drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës
- Prokurimit,
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës-ZKA
 z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-648/022	Data: Datum: 30.08.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), dhe neni 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042, për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 24.08.2022, për themelimin të Komisionit vlerësues të tenderit: "Servisimi Dhe Riparimi i Rentgenit" me numer të prokurimi 633-22-8266-2-3-6, nxjerr:

V E N D I M

1. **THEMELOHET:** Komisioni vlerësues i tenderit: "Servisimi Dhe Riparimi i Rentgenit" më numër të prokurimit: 633-22-8266-2-3-6", dhe në komision caktohen:
 1. **Brahim Hetemaj**, Udh.Sektorit për Shëndetësi;
 2. **Kastriot Idrizaj**, Zyrtar për të hyra Financiare, në QKMF;
 3. **Fisnik Shoshaj**, Zyrtar Ligjor.
2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin "Servisimi Dhe Riparimi i Rentgenit", me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t'i kryej punët dhe përgjigjesit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni .
3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.
4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40, paragrafi 40.3, të Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.
5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.
6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin më të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit, dhe Prokurimi t'ju ofroj qasje në oferta qe kanë shprehur konkurrencë.
7. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesën: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shëndetësi.
8. Vendimi është përfundimtar,

Vendimi i dergohet:

- Komisionit
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivit të Zyrës së Kryetarit

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 649/2022	Data: Datum: 30.08.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-34711, të datës 09.08.2022, të parashtruar nga z.Vesel Zymberaj nga fsh.Serbobranë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e bashkëshortes se tij në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-34711, të datës 09.08.2022 e parashtruar nga z.Vesel Zymberaj, për përkrahje me karburant për dërgimin e bashkëshortes se tij në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore, dhe i lejohen 60 litra karburant.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë z.Vesel Zymberaj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Vesel Zymberaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-34711, të datës 09.08.2022, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i saj. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se bashkëshortja, znj.Miana Zymberaj, është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e tij për marrjen e terapisë në QKUK në Prishtinë.

I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij për në Prishtinë për marrjen e terapisë. Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi. Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dergohet:

- Vesel Zymberaj,
- Shefi i autoparkut,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivit të Zyrës së Kryetarit

